



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tiranë, më 14.10.2025

Nr. 2912 Prot

Lënda: Kërkesë për zhvillimin e një mocioni me debat

Baza Ligjore: Neni 98, pika 1 e Rregullores së Kuvendit

Drejtuar: Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë

Raporti i publikuar së fundmi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për auditimin tematik “mbi disponibilitetin e barnave për trajtimin e sëmundjeve tumorale” evidenton një situatë tej mase të rënduar në të cilën gjendet sot shëndetësia, e në veçanti shërbimi onkologjik pranë Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza për sa i përket shërbimit terapeutik me pajisje mjeksore dhe me barna për dhjetra e mijëra pacientë.

Ndjeshmëria publike nga rastet të njëpasnjëshme me abuzime dhe keq-menazhim ndër vite të bëra publike nga investigimet mediatike, denoncime nga qytetarë të shumtë, por dhe nga raportet e institucioneve të pavarura kushtetuese sikundër KLSH, flasin qartë për nevojën urgjente për ndryshimin e situatës, e cila po agravohet nga dita në ditë.

Kjo është një urgjencë, që kërkon reagim institucional e veprim të shpejtë, pasi për vetë llojin e shërbimit shëndetësor, çdo pacient është në luftë të përditshme për mbijetësë edhe për një ditë tjetër. Nevojitet llogaridhënie institucionale, marrje përgjegjëshësie nga ana e titullarëve apo drejtuesve respektiv dhe kështoj përmirësim i shërbimit për pacientët.

Raporti ka realizuar një auditim të plotë përfundimtar, për institucionin e politikbërjes qendrore Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e duke vazhduar me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor si dhe Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Raporti nxjerr në dritë të dhëna të qarta, të zhveshura nga çdo emocion apo konotacion emocional, qoftë dhe politik, ndaj si ligjvënës është detyrë e jona përtej bindjeve dhe përkatësisë politike ta lexojmë drejtë këtë raport dhe të kërkojmë llogaridhënie institucioneve përgjegjëse, në këtë drejtim Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale.

Raporti paraqet situatën reale atë që qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë tashmë kanë vite që përpigën ta mbulojnë me propagandë boshe apo fasadë godinash disa miliardë lekë të cilat përveç korrupsionit të ndërtimit të tyre, fatkeqsisht nuk ofrojnë asgjë pacientit shqiptar.

Raporti flet me shifra të qarta ku më konkretisht:

1. Procedura të tejzgjatura dhe joefikase për miratimin e barnave tumorale

- Neni 12 i Ligjit nr. 105/2014 është identifikuar si **burokratik dhe pengesë** për miratimin në kohë të barnave antitumorale.
- Nga 25 rastet e shqyrtuara, procesi rezulton me **vonesa të përsëritura dhe vakum rregullator** që kufizon fleksibilitetin e AKBPM-së.
- Si rezultat, **116 barna anti-tumorale (46%)** të autorizuar **nuk janë importuar asnjëherë** në periudhën 2021–2025.

2. Protokolle klinike të vjetruara

- Në QSUNT, **protokollet e praktikës klinike datojnë që prej vitit 2014**, pa përditësime.
- Kjo krijon risk për përdorim barnash më pak efektive dhe kufizon opsionet alternative të trajtimit.

3. Mangësi në menaxhimin e barnave dhe inventarëve

- Në farmacinë qendrore dhe blloqet farmaceutike u konstatua **mospërputhje në datat e skadencës** për barnat, për shkak të mosrespektimit të parimit FIFO.
- Në sistem janë evidentuar **19 flakonë Ifosfamide dhe 602 Methotrexate** të skaduara që ende figurojnë si aktive.
- Sistemet **SISP dhe Pentaho** nuk garantojnë gjurmim të plotë të barnave dhe paraqesin **receta të dublikuara e shkarkime të pasakta**.

4. Sektori i Kapave (përgatitja e barnave citostatike)

- Funksionon me **pajisje manuale dhe të pa kalibruara** që nga viti 2019.
- Mungojnë rregullore standarde pune dhe kontrole laboratorike për përgatitjet e barnave.
- Përzierja e dozave kryhet shpesh nga **infirmierët**, duke rritur riskun për gabime terapeutike.

5. Vonesa dhe mangësi në furnizime

- U identifikuan **49 raste vonesash të pajustificuara** në furnizim nga operatorët farmaceutikë.
- **39 barna anti-tumorale** janë shpërndarë pa kontrata të vlefshme.

- Penalitetet prej **49 milion lekësh** nuk janë aplikuar ndaj operatorëve që kanë shkelur afatet e furnizimit.

6. Nënfinancim dhe boshllëqe buxhetore

- Programi 07330 për barnat anti-tumorale është **nënfinancuar**, duke krijuar periudha të pambluara furnizimi dhe ndërprerje terapie për pacientët.
- Mungon planifikimi afatmesëm (3-vjeçar) për nevojat reale.

7. Mungesë kontrollesh laboratorike dhe inspektimesh

- **AKBPM** nuk ka kryer **asnjë inspektim** në farmacitë spitalore 2022–2024.
- **Laboratori i Kontrollit** ka kryer vetëm **8 analiza** në 3 vite, në kundërshtim me detyrimet ligjore.
- Mungojnë procedura standarde për testimin dhe përzgjedhjen e mostrave.

8. Mungesë bashkëpunimi ndërinstitutional

- Ministria e Shëndetësisë, QSUNT, FSDKSH dhe AKBPM **nuk kanë koordinim efektiv** për planifikimin, furnizimin dhe kontrollin.
- Si pasojë, vendimmarrja është e fragmentuar dhe vonuar, duke ndikuar në sigurinë e trajtimit të pacientëve.

9. Raste kritike të barnave jetike

- **Actinomycin D** nuk ka kontratë apo autorizim tregtimi dhe është siguruar vetëm përmes **donacionit** pa dokumentim zyrtar.
- **Pertuzumab + Trastuzumab (Phesgo)** ka pasur mungesa të zgjatura dhe përdorime të ngatërruara në receta.
- Këto raste rrezikojnë seriozisht **vazhdimësinë e trajtimit onkologjik**.

Raporti nxjerr në pah një **sistem të fragmentuar, të nënfinancuar dhe me mangësi serioze në menaxhim, transparencë dhe kontroll** të barnave anti-tumorale. Auditimi evidenton se mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve, vonesat burokratike dhe mbikëqyrja e dobët kanë **kompromentuar aksesin e pacientëve në trajtime jetike**, duke kërkuar **reformim urgjent institucional dhe ligjor**.

Problematikat, sipas raportit, janë **sistemike**, dhe ndikojnë negativisht në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për pacientët me sëmundje tumorale. Mungesa e barnave, protokollet e vjetruara dhe dobësitë në mbikëqyrje rrisin riskun për cilësinë dhe kontinuitetin e trajtimit.

Është e papërshtueshme kalvari që përballlet sot një pacient i diagnostikuar me sëmundje tumorale i cili duhet të përballlet jo vetëm me neglizhencë të institucioneve për trajtim terapeutik, por mbi të gjitha me një dilemë ekzistencialiste, pasigurisë për barna.

Ndaj kur pacientëve me kancer nuk u garantohen barnat jetike në kohën e duhur, atëherë cënohet jo vetëm e drejta për trajtim, por edhe besimi qytetar në një sistem që duhet të jetë në funksion të jetës dhe shëndetit. Mungesa e barnave tumorale përfaqëson thyerje të kontratës shoqërore midis shtetit dhe qytetarëve të tij. Situata kërkon reflektim të menjëhershëm ndërinstitutional, si dhe masa konkrete dhe efektive për të rikthyer dinjitetin, besimin dhe shpresën te pacientët onkologjikë, të cilët janë tashmë në një betejë të vështirë për jetën.

Për këtë arsye, duke pasur parasysh sa më lart, bazuar dhe në nenin 98 pika 1 të Rregullores së Kuvendit por dhe me qëllim nxitjen e transparencës dhe forcimin e llogaridhënies publike mbi një çështje që prek drejtpërdrejt mirëqenien e qytetarëve shqiptarë, kërkohet zhvillimi i një mocioni me debat në seancë plenare, mbi gjetjet e raportit të KLSH “mbi disponibilitetin e barnave për trajtimin e sëmundjeve tumorale” i cili evidenton një situatë tej mase të rënduar në të cilën gjendet sot shëndetësia, e në veçanti shërbimi onkologjik, për të informuar Kuvendin mbi hapat konkretë që Qeveria ka ndërmarrë dhe planifikon të ndërmarrë për garantimin e së drejtës për shëndet për të gjithë qytetarët në Shqipëri.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT:

Boudk Spodur

Ena Bora

Marije Luku

Klot Shk

put

Tvita Shk

RB

ERISA

XHIXHO

Ch

Redima

Alolli

Shk